

VENDIM
Nr. 6, datë 10.6.2014

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR ARSIMIN, FONDI I ZHVILLIMIT TË RAJONEVE, SI
EDHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 5, DATË 9.5.2014, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR NDARJEN E FONDIT
PËR ARSIMIN, FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE”**

(Ndryshuar me vendimin nr. 19, datë 19.11.2014; nr. 44, datë 27.11.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3 të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 5, datë 9.5.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpalljen e thirrjes për ndarjen e fondit për arsimin, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve”, ndryshon, si më poshtë vijon:

a) “Shpalljen e thirrjes për projekte në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), në lidhje me shpërndarjen e fondeve në vlerën 945 000 000 (nëntëqind e dyzet e pesë milionë) lekë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014...”

2. Shpërndarjen e fondeve për projekte në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), në vlerën 945 000 000 (nëntëqind e dyzet e pesë milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, projektet e të cilave miratohen për t’u financuar, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit, brenda një jave nga publikimi i këtij vendimi, një kalendar me të gjitha afatet e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve (realizimit të investimit), për të vlerësuar realizimin e investimeve, përpara çeljes së fondeve për projektet e miratuara sipas pikës 2 të këtij vendimi.

4. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, projektet e të cilave miratohen për t’u financuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njesisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Arsimit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar

Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Mjedisit	anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

TABELA 1

(Ndryshuar me vendimin nr. 19, datë 19.11.2014; ndryshuar qarku Fier, Tiranë dhe Lezhë sipas tabelës nr. 2 me vendimin nr. 44, datë 27.11.2015)

Tabela 1. Lista e projekteve të Arsimit, me reduktim apo shtesë financimi për 2014, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i Projektit	Vlera e kontratës (me TVSH)	Vlera e financimit 2014 (Lekë)	Fonde që reduktohen (Lekë)	Fonde që shtohen (Lekë)
QARKU BERAT						
1	Komuna Roshnik	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare +kopsht, Karkanj, komuna Roshnik	19,929,917	9,487,338		10,442,579
2	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Thimi Tani" Bashkia Berat	24,334,872	15,882,948		
3	Bashkia Ura Vajgurore	Sistemim, rrethim oborri, ndërtim palestër shkollë e bashkuar, lagjia "4 Shtatori" Ura Vajgurore, Bashkia Ura Vajgurore		17,580,367	8,790,184	
4	Komuna Gjerbes	Rikonstruksion pjesor shkollë 9-vjeçare fshati Zalosnjë, Komuna Gjerbes, Skrapar	5,406,377	5,835,450	429,073	
5	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Kristaq Capo" Bashkia Berat	26,255,240	16,707,257		
QARKU DIBER						
6	Komuna Gjoricë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare dhe palestër Gjoricë, Komuna Gjoricë	38,962,110	19,058,665		
7	Komuna Xibër	Shkollë e bashkuar Xibër, Komuna Xibër	55,673,854	26,836,928		9,351,077
8	Komuna Kala e Dodes	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim palestër Radomir, Komuna Kala e Dodes	38,042,771	21,308,115		16,734,656
9	Komuna Lis	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar "Abdyrrahman Përmeti", Komuna Lis (me prioritet	23,169,907	11,118,140		12,051,767
	Bashkia Peshkopi	Projekti "Shkollë, qendër komunitare": Ndërtimi i 4 terreneve sportive në shkollë të qytetit Peshkopi (shkollë "Nazmi Rrushi"; shkollë "Demir Gashi"; shkollë "Seit Najdeni"; shkollë "Selim Alliu")	31,261,190	19,319,774	19,319,774	
QARKU DURRES						
10	Bashkia Krujë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore në shkollën 9-vjeçare Nr.4, Krujë, Bashkia Krujë	56,546,095	29,673,048		
11	Komuna Nikel	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ramazan Karaj", Nikel, Komuna Nikel	27,952,323	14,812,470		
12	Bashkia Fushë-Krujë	Ndërtim i shkollës së mesme "Shote Galica" Fushë-Krujë	163,231,283	81,901,868		
13	Bashkia Durrës	Ndërtimi i murit rrethues i shkollës "Beqir Çela", Shkozë		2,195,508	2,195,508	
QARKU ELBASAN						
14	Bashkia Belsh	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Halit Uruci" Belsh, Bashkia Belsh	59,762,348	28,956,288		6,901,121
15	Komuna Stebleve	Ndërtim shkollë 1 katëshe, Shkollë Fushë-Studenti, Komuna Steblevë, Librazhd	16,595,565	8,450,744		

16	Komuna Rrajce	Ndërtim shkollë CU Urake, Komuna Rrajce	5,803,069	4,500,269		1,302,800
17	Komuna Orenje	Ndërtim shkollë vartëse Fshati Zdrajsh Verri, Komuna Orenje	4,000,000	4,164,354		
18	Komuna Qender Librazhd	Rikonstruksion shkollë 9-vjeçare Babje, Komuna Qender Librazhd	6,448,248	5,359,987		1,088,261
19	Komuna Qukes	Rikonstruksion shkollë 9-vjeçare "Naim Frasheri" Pishkash, Komuna Qukes	9,591,133	4,851,959		4,739,174
20	Bashkia Elbasan	Perfundim i punimeve në shkollën "Xhafer Hakani", Elbasan	12,000,000	6,000,000		0
21	Komuna Kukur	Rikonstruksion shkollë e bashkuar "Muharrem Zela" Komuna Kukur	20,934,861	10,602,852		0
22	Bashkia Prenjas	Rikonstruksion dhe rrethim shkollë e mesme "Hali Berzheshta" Prenjas, Bashkia Prenjas	10,682,208	8,131,168		0
QARKU FIER						
23	Komuna Mbrostar	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Hiqmet Buzi", fshati Kallm, Komuna Mbrostar	25,655,995	12,443,688		13,212,307
24	Komuna Portez	Ndërtim kopshti, Komuna Portez	7,970,648	5,550,000		0
25	Komuna Dushk	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Thanasaj, Komuna Dushk	15,658,261	8,083,654		7,574,607
26	Komuna Dushk	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Riza Iberli" Zhame-Sektor, Komuna Dushk	28,433,206	14,600,000		13,833,206
27	Komuna Fratar	Ndërtim kopshti i ri, Komuna Fratar	8,594,244	4,385,391		4,208,853
28	Komuna Grabian	Ndërtim kopshti, Fshati 3 Urat, Komuna Grabian	4,431,432	2,419,209		2,012,223
29	Bashkia Patos	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Zhani Ciko", Patos	42,000,000	20,712,154		0
30	Bashkia Divjakë	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Miti Zaka", Bashkia Divjakë	17,657,328	9,483,400		8,173,928
31	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Andon Xoxa" Fier	33,315,328	17,317,955		0
32	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Jani Bakalli" Fier	22,107,000	11,053,611		0
QARKU GJIROKASTER						
33	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Siri Shaplo", Bashkia Gjirokastrë	33,045,000	18,163,567		0
34	Komuna Qesarat	Rikonstruksion shkollë CU fshati Ane-Vjose, Komuna Qesarat, Tepelene	5,143,853	5,785,412	641,559	
	Bashkia Gjirokastrë	Terrene sportive në 4 shkollë (Shkollë "Pandeli Sotiri"; Shkollë "Thoma Papapano"; Shkollë "Cajupi"; Shkollë "Siri Shaplo", lagje Granicë)	28,050,728	18,232,973	18,232,973	
QARKU KORÇE						
35	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Mëshonjtoria e parë"	53,644,475	28,058,008		21,941,992
36	Bashkia Korçë	Projekti "Shkollë, qendër komunitare" : Terrene sportive në 4 shkollë të qytetit Korçë (Shkollë "Demokracia"; Shkollë "Naum Veqilharxhi"; Shkollë "Sotir Gurra"; kompleksi shkollor Rruga "Ajet Xhindoli")		24,115,000		10,885,000

37	Bashkia Maliq	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Kolanec, Bashkia Maliq	2,902,194	2,049,000		853,194
38	Bashkia Maliq	Rikonstruksion nyje sanitare të shkollës së mesme Maliq	1,424,460	1,091,500		332,960
39	Komuna Voskop	Rikonstruksion i shkollës së mesme Voskop sistem ngrohje , Komuna Voskop	35,880,360	17,340,630		14,495,281
40	Komuna Libonik	Ndërtim i shkolles cikli i ulet, fshati Poceste, komuna Libonik	14,010,000	7,617,097		0
QARKU KUKES						
41	Komuna Arren	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare, Arren.	22,190,485	12,095,243		0
42	Bashkia Kukës	Ndërtim i shtesës së shkollës 9-vjeçare "Bajram Curri", Kukës	113,007,475	81,210,826		0
43	Bashkia Krume	Rikonstruksion i shkolles 9 vjeçare Zahrisht, Faza II, Bashkia Krume	14,270,275	7,162,806		7,107,469
QARKU LEZHE						
44	Bashkia Lezhë	Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës, Bashkia Lezhë		13,679,966	6,839,983	
45	Bashkia Rubik	Sistemi i ngrohjes shkolla 9-vjeçare Rubik, Bashkia Rubik	7,965,031	4,023,422		3,941,609
46	Komuna Kacinar	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Kaçinar, Mirditë	14,533,260	8,000,000		0
47	Komuna Blinisht	Rikonstruksioni i shkolles "Pjeter Zahrisht", Komuna Blinisht, Lezhe	21,300,000	10,736,424	5,368,212	
QARKU SHKODER						
48	Bashkia Vau i Dejës	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Aleksandër Paloci" Shelqet, Bashkia Vau i Dejës (shkollë e djegur)	3,649,518	2,921,198		728,320
49	Komuna Bërdicë	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare "Berdice e Madhe", Komuna Berdica	19,800,000	9,993,976		
50	Komuna Gruemirë	Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Gruemirë, Komuna Gruemirë	22,195,654	10,601,502		
51	Komuna Shale	Rikonstruksioni i shkolles 9-vjeçare fshati Gimaj, Komuna Shale	25,359,356	15,250,179		
52	Komuna Fierze	Ndërtim i shkolles 9-vjeçare, fshati Mezi, Puke	28,626,278	14,513,434		
QARKU TIRANE						
53	Bashkia Kavajë	Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.4 tek rruga "Sufajve" komuniteti i romeve Kavaje	28,359,000	10,396,869		3,782,631
54	Komuna Dajt	Shtesë kati i shkollës 9-vjeçare Qesarakë, Komuna Dajt	46,699,592	22,826,749		523,047
55	Komuna Vaqarr	Rikonstruksion , shtesë anësore 2 kate dhe palestër për shkollën e mesme të pergjithshme, Komuna Vaqarr		15,175,938	7,587,969	
56	Komuna Ndroq	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Sadi Nuri", Komuna Ndroq	23,643,197	12,249,199		0
57	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme "Qemal Stafa", Njësia 10		99,594,599	94,594,599	
58	Njesia Bashkiake Nr.2	Rikonstruksion i nyjeve sanitare, Shkolla Ekonomike Tirane	900,000	900,000		0

	Bashkia Tiranë	Projekti "Shkolla, qender komunitare": Terrene sportive në 4 shkolla 9-vjeçare të qytetit Tiranë (shkolla "7 Marsi" prej 6,800,987L; shkolla "Shkolla e Kuqe" prej 3,515,111L; shkolla "Servete Maci" prej 3,515,111L; shkolla "Skënder Luarasi" prej 3,515,111L)	17,346,320	11,275,108	11,275,108	
QARKU VLORE						
59	Komuna Novoselë	Ndërtim shkolla 9-vjeçare "Pilo Prifti", fshati Novoselë, Komuna Novoselë	47,497,121	23,330,826		5,167,446
60	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion kopshti nr.10, Vlorë, Bashkia Vlorë	12,455,832	10,200,165		0
61	Komuna Brataj	Shkolla e mesme e bashkuar "Hamdi Rrap Lazaj" Gjorm, Komuna Brataj	19,618,223	9,995,023		0
62	Komuna Vranisht	Rikonstruksion shkolla e bashkuar Hore Vranisht, Komuna Vranisht	45,618,775	23,035,616		0
63	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare "Zigur Lelo" Vlore, Bashkia Vlorë	20,748,570	11,014,800		9,733,770
64	Bashkia Sarandë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë, Sarandë		15,000,000	15,000,000	0
65	Bashkia Sarandë	Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane		16,845,200	16,845,200	
		TOTALI	1,592,291,845	1,073,266,814	207,120,142	180,234,278

Shënim

1. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim.
2. "Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas vendimeve respektive të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
3. "Fonde që reduktohen" për vitin 2014, tregon vlerën e financimit që i zbritet vlerës së financimit, të parashikuar për vitin 2014, për projektet me performancë të ulët, në zbatimin e punimeve.
4. "Fonde që shtohen" për vitin 2014, tregon vlerën e financimit, që i shtohen vlerës së financimit të parashikuar për vitin 2014, për projektet me ecuri punimesh përtej parashikimeve financiare, në 2014.

Tabela 2. Lista e projekteve të Arsimit, me cikël financimi 2014 - 2015, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Nr	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e miratuar e financimit në vitin 2015 (në lekë)	Ndryshimi i vlerës së financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e Financimit për vitin 2016 (në lekë)
QARKU FIER						
1	Bashkia Fier	Projekti "Shkolla, qender komunitare": Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në shkollë të qytetit Fier, me lote (Shkolla "Jani Bakalli" prej 4,477,452L; Shkolla "Liri Gero" prej 5,323,962L; Shkolla "Kristaq Gero" prej 5,323,962L; Shkolla "Pinellopi Pirro" prej 5,323,962L)	18,021,394	13,465,677	(+)4,555,717	0
2	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Jani Bakalli" Fier	17,751,039	22,107,000	(-)4,355,961	0
QARKU TIRANE						
3	Bashkia Tirane	Rikonstruksion , shtesë anësore 2 kate dhe palestër për shkollën e mesme të përgjithshme, Komuna Vaqarr	31,801,747	26,000,000	(+)5,801,747	0
4	Bashkia Tiranë	Projekti "Shkolla, qender komunitare": Terrene sportive në 4 shkollë 9-vjeçare të qytetit Tiranë (shkolla "7 Marsi" prej 6,800,987L; shkolla "Shkolla e Kuqe" prej 3,515,111L; shkolla "Servete Maci" prej 3,515,111L; shkolla "Skënder Luarasi" prej 3,515,111L)	14,261,658	17,346,320	(-)3,084,662	0
QARKU LEZHE						
5	Bashkia Lezhë	Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës, Bashkia Lezhë	27,499,128	28,359,932	(-)860,804	0
6	Bashkia Lezhë	Ndërtimi i qendrës sportive tip, tek kompleksi i shkollave (2 qendra)	19,744,022	20,518,380	(-)774,358	0
TOTALI			129,078,988	127,797,309	10,357,464	0

Shënim:

- "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
- "Vlera e miratuar financimit" për vitin 2015 tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objekteve.
- "Ndryshimi i vlerës së financimit", për vitin 2015, tregon vlerën e reduktuar ose të shtuar të financimit për vitin 2015, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së financimit të miratuar për vitin 2015, të ndryshuar sipas komunikimit zyrtar nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit).
- "Vlera e financimit" për vitin 2016, tregon vlerën për t'u financuar për vitin 2016.